



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2025

Datë: 29.04.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe duke u mbështetur në dispozitat e Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datë 28.12.2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2025 pas diskutimit lidhur me pikën 3 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme në Pronësi të Prenk Nikolla, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Këmbimin e Pronës Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale me pronën private në pronësi të Prenk Nikolla.
2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen në mes të Komunës së Gjakovës dhe Pronës private në pronësi të Prenk Nikolla ka këto të dhëna:
 - 2.1. Pjesë e Parcelës Kadastrale nr. P-70705057-02091-0, Zona Kadastrale Pjetërshan, e evidentuar në Pronësi PSH. Rrugë Publike, sipas dokumenteve të Planifikimit Hapësinor ka destinimin si Zonë Banimi me kodin ZB2/Banim me një njësi .
 - 2.2 Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale P-70705057-02151-1 Zona Kadastrale Pjetërshan, në pronësi private të Prenk Nikolla, sipas dokumenteve të Planifikimit Hapësinor ka destinim si Zonë Banimi me kodin ZB2/Banim me një njësi dhe pjesërisht si Zonë e Komunikacionit dhe transportit me kodin ZKT/Rrugë.
3. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme është realizimi i dokumenteve të Planifikimit Hapësinor, si dhe për shkak të gjendjes faktike, pjesa e parcelës që do të këmbehet do të shfrytëzohet si rrugë ekzistuese.
4. Pjesa e sipërfaqes që do të këmbehet është 425.00m² sipas dokumentacionit të bashkangjitur si dhe raportit të vlerësimit të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Mënyra dhe kushtet e Këmbimit të Pronës së Paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe Pronarit të paluajtshmërisë që do të këmbëhet.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

7. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit

Arbëneshja Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

